



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 9 dhjetor 2020

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi apelin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me
arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës së Apelit” ose përkatësisht “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹, në përputhje me nenin 33(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) ka marrë në shqyrtim apelimin e ndërmjetëm të dorëzuar nga Hysni Gucati (“Gucati”)² kundër vendimeve të Gjykatës të Procedurës Paraprake lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij dhe kërkesën për dorëzani.³ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj më 13 nëntor 2020.⁴ Z. Gucati dorëzoi kundërpërgjigjen e tij më 19 nëntor 2020.⁵

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 shtator 2020, gjykatësi Nikola Giju, Gjykatës i Vetëm, lëshoi fletarrestime për Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn⁶, sipas kërkesës së ZPS-së⁷, së bashku me urdhrat për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë.⁸ Fletarrestimi për z. Gucati u lëshua për veprat penale kundër

¹ F000002, *Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit*, 4 nëntor 2020.

² F00001/A01, *Njoftim për Apel të Ndërmjetëm në Emër të Hysni Gucatit* (“apeluesi”), 3 nëntor 2020, dhe *Njoftim për Apel të Ndërmjetëm në Emër të Hysni Gucatit* (“apeluesi”), 3 nëntor 2020, Shtojca 1 (“Apeli”).

³ F00057, *Vendim mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes*, 27 tetor 2020 (“Vendim mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes”); F00059, *Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani*, 27 tetor 2020 (“Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani”).

⁴ F00003, *Përgjigja e Prokurorisë ndaj Apelit prej Mbrojtjes të Vendimit për Refuzimin e Lirimit*, 13 nëntor 2020 (“përgjigja”).

⁵ F00004, *Kundërpërgjigje e Apeluesit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë*, 19 nëntor 2020 (“kundërpërgjigja”).

⁶ F000128/A01/RED, *Versioni i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 25 shtator 2020 (“Fletarrestimi”); F00012/A03/COR/RED, *Versioni i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 26 shtator 2020 (versioni origjinal u protokollua më 22 shtator 2020). Shih gjithashtu F00012, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 24 shtator 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si dokument publik më 9 tetor 2020) (“Vendimi për Fletarrestimet”).

⁷ F00009RED, *Versioni i Redaktuar Publik i Kërkesës Urgjente për Fletarrestime dhe Urdhra të Lidhur me to’, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-07/F0009 i datës 22 shtator 2020, me shtojcat publike 1-2*, 1 tetor 2020 (“Kërkesa e ZPS-së për Fletarrestime”), . Kërkesa e ZPS-së mbështetet në nenet 35(2), 39(3) dhe 41 të Ligjit dhe rregullat 48, 50, 53 dhe 55 të Rregullores. Shih Kërkesën e Prokurorisë për Fletarrestime, para.1.

⁸ F00012/A02/RED, *Versioni i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020; F00012/A04/RED, *Versioni i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020.

administrimit të drejtësisë, të ndëshkueshme sipas Kodit Penal të Kosovës, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.⁹

2. Më 25 shtator 2020, të dyshuarit u arrestuan në Kosovë.¹⁰ Z. Gucati u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së të njëjtën ditë.¹¹

3. Më 30 shtator 2020, z. Gucati dorëzoi tri kërkesa që kundërshtonin ligjshmërinë e arrestimit të tij dhe një kërkesë për lirim të tij me dorëzani.¹² Më 9 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi një përgjigje përmbledhëse që i kundërshtonte kundërshtonte këto kërkesa.¹³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Neni 45(2) i Ligjit parashikon se:

Ankesat e ndërmjetme do të jenë të pranueshme që nga marrja e vendimeve apo urdhrave që kanë të bëjnë me paraburgimin apo me ndonjë parashitje paraprake për kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Çdo ankese tjetër të ndërmjetme duhet t'i aprovohet leja për ankese përmes vërtetimit nga ana e gjykatës të procedurës paraprake ose trupit gjykues [...]

5. Që në fillim, Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se as Ligji dhe as Rregullorja e Procedurës dhe Provave nuk specifikojnë standardin e rishikimit që duhet të zbatohet

⁹ Fletarrestimi, para. 1-3.

¹⁰ F00015, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020; F00016, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020.

¹¹ F00018, *Njoftim i Pranimi të Hysni Gucati në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020 me shtojcën konfidenciale 1.

¹² F00032, *Kundërshtim i Ligjshmërisë së Arrestimit në pajtim me Nenin 41(2): Kërkesë për Caktimin e një Gjykatësi Tjetër për të Vendosur në lidhje me Kundërshtimin*, 30 shtator 2020; F00033, *Kundërshtim i Ligjshmërisë së Arrestimit në pajtim me Nenin 41(2): Kërkesë për Dhënie të Informacionit*, 30 shtator 2020; F00034, *Kundërshtim i Ligjshmërisë së Arrestimit në pajtim me Nenin 41(2): Fletarrestimi Është Lëshuar pa Autoritet të Ligjshëm*, 30 shtator 2020 ("Kundërshtim i Ligjshmërisë së Arrestimit në Pajtim me Nenin 41(2)"); F00038, *Kërkesë për Dorëzani*, 30 shtator 2020.

¹³ F00045, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Mocioneve të Mbrojtjes në Kundërshtim të Ligjshmërisë së Arrestimit dhe Kërkesës për Lirim*, 9 tetor 2020.

për apelet e ndërmjetme.¹⁴ Megjithatë, neni 46(1) i Ligjit specifikon arsyet mbi bazën e të cilave mund të bëhen apeline kundër vendimit:

- (i) ndonjë gabim rreth ndonjë çështjeje juridike që e shfuqizon aktgjykimin;
- (ii) ndonjë gabim faktik, i cili ka shkaktuar dështimin e drejtësisë; ose
- (iii) [ndonjë gabim për sa i përket dhënies së dënimit].

6. Neni 46(2) i Ligjit parasheh më tej se “ankesa nuk është gjykim *de novo*”.

7. Ligji parasheh në lidhje me gabimet e faktit se:

Kur paneli i Gjykatës së Apelit përcakton se trupi gjykues ka bërë gabim juridik në ndonjë aktgjykim që rrjedh nga zbatimi i ndonjë standardi të pasaktë ligjor, Dhoma e Gjykatës së Apelit e artikulon standardin e duhur ligjor dhe e zbaton atë standard ndaj provave të përfshira në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor për të përcaktuar nëse fajësia e apeluar duhet të konfirmohet, të pranohet apo të hidhet poshtë. Përndryshe, nëse trupi gjykues është në dispozicion dhe mund ta trajtojë çështjen në mënyrë më efikase, Paneli i Gjykatës së Apelit mund ta kthejë rastin tek trupi gjykues për të rishikuar konstatimet e tij dhe provat bazuar në standardin e duhur ligjor.¹⁵

8. Lidhur me gabimet faktike, Ligji parasheh sa më poshtë:

Me rastin e shqyrtimit të konstatimeve faktike të trupit gjykues, Paneli i Gjykatës së Apelit vetëm i zëvendëson konstatimet e trupit gjykues me konstatimet e veta atëherë kur provat në të cilat është bazuar trupi gjykues nuk kanë mundur të pranohen nga asnjë gjykim i arsyeshëm i fakteve apo kur vlerësimi i provave është tërësisht i gabuar.¹⁶

¹⁴ I vetmi përjashtim është rregulla 113(6) e Rregullores, që përcakton se një palë mund të kërkojë leje për apelim të vendimit në lidhje me pjesëmarrjen e viktimës “vetëm mbi bazën e gabimeve ligjore”.

¹⁵ Neni 46(4) i Ligjit.

¹⁶ Neni 46(5) i Ligjit.

9. Dhomat e Specializuara nuk janë të vetme sa i takon mungesës së shtjellimit të qartë ligjor të standardeve të rishikimit për apelet e ndërmjetme. Statutet dhe Rregulloret e Procedurës dhe Provave të TPNJ-së, TNPR-së, MPNTP-së, GJPN-së, GJSSL-së dhe TTSL-së gjithashtu nuk shprehen mbi këtë pikë.

10. Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se këto gjykata kanë shtjelluar standarde të ndërmjetme të zbatueshme përmes jurisprudencës së tyre përkatëse, përfshirë në lidhje me vendimet diskrecionale. Rrjedhimisht, Paneli konsideron se ai ka të njëjtin autoritet për të përcaktuar standardin e rishikimit të zbatueshëm për apelet e ndërmjetme të paraqitura para Dhomave të Specializuara. Në përputhje me këtë, Paneli do të zbatojë standardin e përcaktuar tashmë për apelimet kundër aktgjyqimeve *mutatis mutandis* edhe për apelet e ndërmjetme.

11. Ligji parashikon qartë se: “Gjykatësit mund të ndihmohen nga burime të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë burime dytësore, siç janë jurisprudenca nga gjykatat ndërkombëtare *ad hoc*, Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe gjykatat e tjera penale”.¹⁷ Paneli i Gjykatës së Apelit konsideron se këto burime dytësore mund të ndihmojnë gjithashtu gjykatësit në reflektimet e tyre në rastet kur burimet parësore nuk japin udhëzime mbi një çështje konkrete, të tillë si standardi që duhet të zbatohet lidhur me apelimet e ndërmjetme. Bazuar në sa më sipër, Paneli i Gjykatës së Apelit konsideron se ka të drejtën e qenësishme të përcaktojë standardin e vet të rishikimit duke marrë parasysh jurisprudencën përkatëse të gjykatave penale ndërkombëtare.

12. Jo çdo gabim ligjor ose faktik çon në rrëzimin e vendimit të kundërshtuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Një palë që pretendon një gabim ligjor duhet të identifikojë gabimin e pretenduar, të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimit dhe të shpjegojë se si e bën gabimi vendimin të pavlefshëm. Një pretendim për gabim ligjor që nuk ka asnjë gjasë të ndryshojë rezultatin e një vendimi, mund të refuzohet për këtë arsye. Megjithatë, edhe nëse argumentet e palës janë të pamjaftueshme për të

¹⁷ Neni 3(3) i Ligjit.

mbështetur pretendimin për gabimin në fjalë, Paneli mund të konstatojë për arsye të tjera që ekziston një gabim ligjor.¹⁸

13. Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton ekzistencën e një gabimi faktik vetëm kur asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk mund të arrijë në konstatimin e kundërshtuar. Jo çdo gabim faktik çon në rrëzimin e një vendimi të një paneli të nivelit më të ulët nga Paneli [i Gjykatës së Apelit], por vetëm një gabim që ka shkaktuar vendim gjyqësor të gabuar gjyqësor të gabuar. Në përcaktimin e arsyeshmërisë së një konstatimi, Paneli nuk i përmbys lehtë konstatimet faktike të bëra nga një panel i nivelit më të ulët.¹⁹

14. Nëse vendimi që kundërshtohet është vendim diskrecional, pala duhet të demonstrojë se paneli i nivelit më të ulët ka kryer një gabim të dukshëm, në kuptimin që vendimi: (i) është bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit të zbatueshëm; (ii) është bazuar në një përfundim faktik qartazi të gabuar; ose (iii) është kaq i padrejtë ose i paarsyeshëm saqë përbën keqpërdorim të diskrecionit nga paneli i nivelit më të ulët.²⁰ Paneli i Gjykatës së Apelit gjithashtu do të shqyrtojë nëse paneli i nivelit më të

¹⁸ ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-A, Judgement, 29 November 2017 (“*Prlić et al. Appeal Judgement*”), para. 19; ICTR, *Prosecutor v. Nyiramasuhuko et al.*, ICTR-98-42-A, Judgement, 14 December 2015 (“*Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*”), para. 30, 31; IRMCT, *Prosecutor v. Karadžić*, MICT-13-55-A, Judgement, 20 March 2019 (“*Karadžić Appeal Judgement*”), para. 15; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-01-A, Judgment, 26 September 2013 (“*Taylor Appeal Judgement*”), para. 25; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/AC/AR90.1, F0020, Decision on the Defence Appeals Against the Trial Chamber’s “Decision on the Defence Challenges to the Jurisdiction and Legality of the Tribunal”, 24 October 2012, para. 10.

¹⁹ ICTY, *Prlić et al. Appeal Judgement*, para. 21; ICTR, *Nyiramasuhuko et al. Appeal Judgement*, para. 32; IRMCT, *Karadžić Appeal Judgement*, para. 17; SCSL, *Taylor Appeal Judgement*, para. 26-27. IRMCT.

²⁰ Shih, për shembull, ICTY/TPNJ, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve.*, IT-04-84-AR65.2, Vendim mbi Apelin e Ndërmjetëm të Lahi Brahimaajt kundër Vendimit të Trupit Gjyqësor për Refuzimin e Lirimit të Përkohshëm, 9 mars 2006, para. 5; ICTR, *Karemera et al. v. Prosecutor*, ICTR-98-44-AR65, Decision on Matthieu Ndirumpatse’s Appeal Against Decision on Remand on Provisional Release, 8 December 2009, para. 5; IRMCT, *Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-AR68.2/3, Decision on Prosecution Appeal Against the Decision Granting Fatuma Provisional Release, 9 August 2019, para. 5; IRMCT, *Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-AR68.5, Decision on Prosecution Appeal Against the Decision Granting Turinabo and Ndagijimana Provisional Release, 5 August 2019, para. 6; ICC, *Prosecutor v. Abd-Al-Rahman*, ICC-02/05-01/20_177, Judgment on the Appeal of Mr Muhammad Ali Abd-Al-Rahman Against the Decision of the Pre-Trial Chamber II of 14 August 2020 entitled “Decision on the Defence

ulët u ka dhënë peshë aspekteve të jashtme ose të parëndësishme, ose nuk u ka dhënë peshë, ose nuk u ka dhënë peshë të mjaftueshme, aspekteve të rëndësishme gjatë marrjes së vendimit prej tij.²¹

III. DISKUTIM

A. ÇËSHTJE PARAPRAKE

1. Parashtrimi i apelit të z. Gucati në bazë të së drejtës së vetvetishme

15. Neni 45(2) i Ligjit parashikon se ankesat e ndërmjetme do të jenë të pranueshme që nga marrja e vendimeve apo urdhrave që kanë të bëjnë me paraburgimin apo me ndonjë parashtrësë paraprake për kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Çdo ankese tjetër të ndërmjetme duhet t'i aprovohet leja për ankesë përmes vërtetimit nga ana e Gjykatës të Procedurës Paraprake ose trupit gjykues.²²

16. Z. Gucati paraqiti apel në bazë të së drejtës së tij të vetvetishme²³, pavarësisht ftesës së Gjykatës të Vetëm për të kërkuar leje për apelim të Vendimit mbi kundërshtimet e Mbrojtjes.²⁴ Përpara trajtimit të themelësisë së parashtrimeve të z. Gucati, Paneli i Gjykatës së Apelit duhet të bindet që apeli është parashtruar në mënyrë të vlefshme mbi bazën e së drejtës së vetvetishme për apel.

17. Paneli i Gjykatës së Apelit mendon se pika e parë e apelit të z. Gucati nuk përbën kundërshtim të juridiksionit të Dhomave të Specializuara, pasi parashtrimet e tij nuk kanë të bëjnë me juridiksionin personal, territorial, kohor dhe lëndor, por kanë

Request for Interim Release", 8 October 2020, para. 13-15; ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-601-Red, Judgment on the Appeal of Mr Al Hassan Against the Decision of the Pre-Trial Chamber I entitled 'Décision relative à l'exception d'irrecevabilité pour insuffisance de gravité de l'affaire soulevée par la défense', 19 February 2020, para. 37-40; SCSL, *Prosecutor v. Fofona*, SCSL-04-14-AR65, Appeal Against Decision Refusing Bail, 11 March 2005, para. 20.

²¹ *Po aty*.

²² Neni 45(2) i Ligjit.

²³ Apeli, para. 4-7; Kundërpërgjigja, para. 23.

²⁴ Vendimi mbi kundërshtimet e Mbrojtjes, para. 47.

të bëjnë me kundërshtimin e ligjshmërisë së arrestimit të tij.²⁵ Megjithatë, Paneli konstaton se kundërshtimi i ligjshmërisë së arrestimit të një individi përfshihet në kategorinë më të gjerë të kundërshtimeve ndaj mbajtjes në paraburgim, për të cilën ekziston e drejta e vetvetishme për apel.²⁶

18. Pika e dytë e apelit të z. Gucati, e cila lidhet me kundërshtimin e konstatimit të Gjykatës të Vetëm se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm, lidhet qartazi me mbajtjen e tij në paraburgim, për të cilën ekziston e drejta e vetvetishme për apel.

19. Për këto arsye, apeli është i pranueshëm në këtë aspekt. Ndonëse ky përcaktim është parakusht që Paneli i Gjykatës së Apelit të ushtrojë juridiksionin e tij, ai nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar justifikuar ndërhyrjen e tij. Procedimet para Panelit të Gjykatës së Apelit kanë natyrë korrigjuese. Rrjedhimisht, çdo arsye për apel që nuk përputhet me kërkesat formale të apelit, dhe veçanërisht mosdhënia e arsyetimit ose mospërcaktimi i bazës mbi të cilën bëhet apeli, mund të hidhet poshtë *in limine*.²⁷

2. Kriteret formale për paraqitje të apelit

²⁵ Vihet re se në çështjen *Tolimir*, Dhoma e Apelit e TPNJ-së konstatoi se kundërshtimet ndaj ligjshmërisë së arrestimit të një personi nuk mund të konsiderohen si apel kundër juridiksionit. Shih ICTY, *Prosecutor v. Tolimir*, IT-05-88/2-AR72.2, Decision on Zdravko Tolimir's Appeal Against the Decision on Submissions of the Accused Concerning Legality of Arrest, 12 March 2009, para. 11-13, të cilat i referohen ICTY, *Prosecutor v. Nikolić*, IT-94-2-AR72, Decision on Notice of Appeal, 9 janar 2003, f. 3.

²⁶ Në bazë të Aktvendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese të datës 26 maj 2020, periudha që do të merret parasysh për përcaktimin e kohëzgjatjes së paraburgimit në pritje të gjyqimit sipas nenit 29(2) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 5(3) të KEDNJ-së fillon në ditën kur i akuzuari merret në paraburgim dhe përfundon kur ai ose ajo lirohet, ose kur përcaktohet akuza, edhe nëse vetëm nga një panel i shkallës së parë. Shih KSC-CC-PR-2020-09/F00006, Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 26 maj 2020, ("Aktvendimi i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese i datës 26 maj 2020") para. 62 (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. Republic of Moldova*, no. 23755/07, Judgment, 5 July 2016, para. 85 (ku përcaktohet se periudha që do të merret parasysh kur shqyrtohet mbajtja në paraburgim "fillon nga momenti kur personi arrestohet").

²⁷ Shih, për shembull, ICC, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al.*, ICC-01/05-01/13-2275-Red, Judgment on the Appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr Aimé Kilolo Musamba, Mr Jean-Jacques Magenda Kabongo, Mr Fidèle Balala Wandu and Mr Narcisse Arido Against the Decision of the Trial Chamber VII entitled "Judgment pursuant to Article 74 of the Statute", 8 March 2018, para. 530. Shih gjithashtu nenin 46(2) të Ligjit, i cili parashikon se apeli nuk është gjykim *de novo*.

20. Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se në apelin e tij, z. Gucati përsërit argumentet që u hodhën poshtë nga Gjykatësi i Vetëm, përgjithësisht nuk paraqet prova për të vërtetuar pretendimet për gabime,²⁸ ose thjesht deklaron se Gjykatësi i Vetëm kishte bërë gabim.²⁹

21. ZPS-ja përgjigjet se apeli duhet të rrëzohet për shkak se z. Gucati thjesht shpreh mospajtim me Gjykatësin e Vetëm, pa demonstruar se është bërë ndonjë gabim.³⁰ Z. Gucati kundërpërgjigjet duke qartësuar se ai synon të ngrejë pretendim për gabim ligjor lidhur me pikën e parë të apelit, ndërsa pika e dytë e apelit ngre një “çështje gjykimi”.³¹ Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se këto argumente duhet të ishin ngritur në apel dhe të mos ishin ngritur për herë të parë në kundërpërgjigje, në mënyrë që palës kundërshtuese të mos i mohohet mundësia e përgjigjes.³²

22. Paneli i Gjykatës së Apelit është i vetëdijshëm për jurisprudencën përkatëse që lejon hedhjen poshtë me procedurë të shkurtuar të argumenteve të ngjashme të pabazuara dhe të paargumentuara³³. Megjithatë, Paneli vendosi të shqyrtojë apelin, duke pasur parasysh që kundërshtimet e ngritura në të kanë të bëjnë me të drejtat themelore të z. Gucati, përfshirë të drejtën e tij për liri.

B. PIKA E PARË E AELIT TË Z. GUCATI: PRETENDIMI PËR GABIM LIDHUR ME KOMPETENCËN E GJYKATËSIT TË VETËM PËR TË LËSHUAR FLETARRESTIM

²⁸ Krahaso: Apelin, para. 8-15, 17-25, 30-31 me *Kundërshtimin e Ligjshmërisë së Arrestimit*, para. 1-17. Shih gjithashtu, Përgjigjja, shënimi 63.

²⁹ Apeli, para. 53, 56, 58.

³⁰ Shih, për shembull, Përgjigjja, para. 21, 30.

³¹ Kundërpërgjigjja, para. 9, 10, 12-15, 18-19, 21-23.

³² *IRMCT, Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-PT, Decision on Motion for Access to Prosecution Requests for Assistance and Responses Thereto, 18 April 2019, shënimi 22. Shih gjithashtu nenin 50(1) të Udhëzuesit të Punës Dosjet dhe Parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (KSC-BD-15), ku thuhet se: “dosja e kundërpërgjigjes e parashtruar sipas rregullës 179(3) dhe rregullës 186(3) të Rregullores [...] përmban vetëm argumente kundërpërgjigjëse ndaj dosjes”.

³³ *ICTY, Prosecutor v. Milošević*, IT-98-29/1-A, Judgement, 12 November 2009, para. 17; *ICTY, Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-A, Judgement, 17 korrik 2008, para. 18-24; *ICTY, Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, Judgement, 3 April 2007, para. 17-31.

23. Z. Gucati parashtron se arrestimi i tij është i paligjshëm dhe se ai duhet të lirohet në pajtim me nenin 41(2) të Ligjit.³⁴ Sipas z. Gucati, Ligji parasheh vetëm dy mundësi për mbajtjen e një personi në paraburgim para gjykimit.³⁵

24. Sipas këndvështrimit të z. Gucati, neni 39(3) i Ligjit i jep Gjykatësit të Procedurës Paraprake kompetencë për të lëshuar fletarreste dhe kjo kompetencë nuk mund të ushtrohet para paraqitjes së aktakuzës.³⁶ Gucati pretendon se as rregulla 57(1) e Rregullores, e cila lidhet me paraburgimin e një të dyshuari, nuk lejon lëshimin e fletarrestimit nga Gjykatësi i Vetëm.³⁷ Gucati thekson se, që paraburgimi të jetë i ligjshëm, ai duhet të kryhet në pajtim me dispozitat materiale dhe procedurale të zbatueshme.³⁸ Për më tepër, z. Gucati pretendon se arrestimi i tij duhet të ishte urdhëruar nga ZPS-ja në pajtim me nenin 35(2)(h) të Ligjit³⁹ dhe se fakti që nuk është vepruar kështu i ka mohuar atij mbrojtjet shtesë që i ofrohen një të dyshuari gjatë fazës hetimore.⁴⁰

25. ZPS-ja përgjigjet se z. Gucati përgjithësisht përsërit argumentet e rrëzuara nga Gjykatësi i Vetëm, pa demonstruar se është bërë ndonjë gabim. Sipas ZPS-së, argumenti i ri i paraqitur nga z. Gucati, përkatësisht se vetëm ZPS-ja mund të arrestojë një individ gjatë fazës hetimore, është jo logjik dhe i pabazuar.⁴¹

³⁴ Apeli, para. 8-31; Kundërpërgjigjja, para. 21, 38.

³⁵ Apeli, para. 12-15, 26-28; Kundërpërgjigjja, para. 24, 26, 29-35 (të cilat i referohen kompetencës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake në pajtim me nenin 39(3) të Ligjit dhe kompetencës së ZPS-së në pajtim me nenin 35(2)(h) të Ligjit).

³⁶ Apeli, para. 12-15, 26, 28, 30; Kundërpërgjigjja, para. 24-26.

³⁷ Apeli, para 25; Kundërpërgjigjja, para. 27, 34-36. Sipas Gucatit, rregulla 57(1) zbatohet vetëm për paraburgimin e urdhëruar nga ZPS-ja sipas nenit 35(2)(h) të Ligjit. *Shih* Apeli, para. 25-26; Kundërpërgjigjja, para. 27.

³⁸ Kundërpërgjigjja, para. 2, 39.

³⁹ Kundërpërgjigjja, para. 37.

⁴⁰ Kundërpërgjigjja, para. 38.

⁴¹ Përgjigjja, para. 24-26. Për më tepër, sipas ZPS-së, ky argument nuk merr parasysh nenin 41(3) të Ligjit, si edhe dispozita të tjera të Dhomave të Specializuara, të cilat parashohin kompetenca për gjykatësit e DHS-së për të urdhëruar arrestimin dhe paraburgimin para konfirmimit të aktakuzës. Përgjigjja, para. 23-26. Parashtrimi se neni 41(3) i Ligjit jep një farë qartësie lidhur me këtë pikë nuk është bindës, pasi ai i referohet paraburgimit “pa urdhër nga Dhomat e Specializuara”. Në fakt, neni 41(3) i

26. Kur trajtoi çështjen e kompetencës së tij lidhur me lëshimin e fletarrestimit, Gjykatësi i Vetëm vërejti se, meqenëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktohet vetëm pas ngritjes së aktakuzës, çdo arrestim i një të dyshuari domosdoshmërisht do të duhej të urdhërohej dhe rishikohej nga Gjykatësi i Vetëm i caktuar në pajtim me nenin 33(2) të Ligjit⁴². Gjykatësi i Vetëm konstatoi më tej se dispozitat e Dhomave të Specializuara nuk e kufizojnë kompetencën për lëshimin e një fletarrestimi vetëm tek Gjykatësi i Procedurës Paraprake⁴³.

27. Ndonëse Paneli i Gjykatës së Apelit, për arsyet e shpjeguara më poshtë, pajtohet që kompetenca për lëshimin e një fletarrestimi nuk është e drejtë vetëm e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Paneli sidoqoftë konstaton se fletarrestimi i lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm bazohet gabimisht në nenin 39(3) të Ligjit⁴⁴. Është e qartë se neni 39(3) i Ligjit i referohet shprehimisht kompetencës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të lëshuar fletarrestim pas ngritjes së një aktakuze dhe nuk zbatohet për kompetencat që mund të ketë Gjykatësi i Vetëm kur ai caktohet në pajtim me nenin 33(2) të Ligjit.⁴⁵

28. Megjithatë, Paneli i Gjykatës së Apelit është i mendimit se mbështetja te neni 39(3) i Ligjit për fletarrestimin jo domosdoshmërisht e bën paraburgimin e z. Gucati të paligjshëm, për sa kohë që lëshimi i fletarrestimit nga Gjykatësi i Vetëm lejohet nga kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara dhe për sa kohë janë përmbushur kushtet materiale të parapara në dispozitat procedurale të zbatueshme për paraburgimin.

Ligjit lidhet me kompetencat e ZPS-së për të urdhëruar arrestimin e një personi gjatë fazës hetimore të procedimit në pajtim me nenin 35(2)(f) të Ligjit.

⁴² *Vendimi mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes*, para. 30.

⁴³ *Vendimi mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes*, para. 30.

⁴⁴ Apeli, para. 12-15. Shih gjithashtu *Vendim mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes*, f. 1; Fletarrestimi, f. 1. Konstatime të tjera të Gjykatësit të Vetëm mbi këtë çështje i referohen gjithashtu nenit 39(3) të Ligjit dhe kompetencave të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Shih, për shembull, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime*, para. 8.

⁴⁵ Shih nenin 39(3) të Ligjit. Shih gjithashtu F00003, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas Nenin 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018 (“Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm”).

29. Në këtë aspekt, Paneli së pari kujton statusin e barabartë të të gjithë gjykatësve të Dhomave të Specializuara, pavarësisht detyrës së tyre konkrete. Paneli i Gjykatës së Apelit vëren më tej se, ndryshe nga dispozitat që përcaktojnë në mënyrë të qartë kompetencat dhe funksionet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake⁴⁶, Trupit Gjykues⁴⁷, Panelit të Gjykatës së Apelit dhe Panelit të Gjykatës Supreme⁴⁸, kompetencat e Gjykatësit të Vetëm përcaktohen vetëm sipas përcaktimeve të përgjithshme të nenit 33(2) të Ligjit. Sipas kësaj dispozite, Gjykatësi i Vetëm mund të caktohet që të merret me një çështje që kërkon caktimin e një gjykatësi tjetër përveç Gjykatësit të Procedurës Paraprake.⁴⁹

30. Shqyrtimi i dispozitave përkatëse të Dhomave të Specializuara është i dobishëm për të përcaktuar nëse, në mungesë të një dispozite të qartë që i jep Gjykatësit të Vetëm kompetencën për të lëshuar fletarrestim për një të dyshuar, kjo kompetencë megjithatë ekziston. Paneli i Gjykatës së Apelit është i vetëdijshëm për faktin se kur ka një konflikt midis Ligjit dhe Rregullores, epërsi ka Ligji.⁵⁰ Paneli më tej konstaton se doktrina e "interpretimit harmonik" e zbatuar nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese është udhëzuese në këtë drejtim⁵¹. Gjatë rishikimit të Rregullores dhe e kushtëzuar prej detyrimit për t'u bazuar në kuptimin

⁴⁶ Neni 39 i Ligjit.

⁴⁷ Neni 40 i Ligjit.

⁴⁸ Nenet 46 dhe 47 të Ligjit.

⁴⁹ Neni 33(2) i Ligjit. Vendimi për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm gjithashtu vëren "fushëveprimin e gjerë" të nenit 33(2) të Ligjit. Shih *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm*, para. 14.

⁵⁰ Shih rregullën 4(2) të Rregullores. Shih gjithashtu nenin 19(3) të Ligjit, i cili parasheh se Rregullorja duhet të jetë në përputhje me këtë ligj.

⁵¹ Kjo është një doktrinë e përgjithshme në të drejtën kushtetuese (krahasuese), shih për Francën ("concordance pratique") Morand, C.-A., "Vers une méthodologie de la pesée des valeurs Constitutionnelles" në *De la Constitution. Études en l'honneur de Jean-François Aubert*, Helbing & Lichtenhahn 1996, f. 57; për Gjermaninë ("praktische Konkordanz") Hesse, K., *Grundzüge des Verfassungsrechts der Bundesrepublik Deutschland*, C.F. Müller 1999 (ribotim i 20-të, 1995), para. 2 mn. 72. Në SH.B.A., megjithëse e drejta zakonore bën më pak përpjekje për të pasur koherencë sistematike, i njëjti parim, pa dyshim, ngërthehet në rregullin interpretues të "parimit të leximit harmonik" (që do të thotë se dispozitat e një teksti duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që i bën ato të përputhshme, jo kontradiktore), cf. Scalia, A. dhe Garner, B.A., *Reading Law: The Interpretation of Legal Texts*, Thomson Reuters 2012, f. 383-388.

e drejtpërdrejtë të tekstit, , Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese: “nuk e interpreton një rregull më vete, por në kontekstin e rregullave të tjera dhe dispozitave përkatëse të Ligjit me qëllim harmonizimin me to”.⁵²

31. Së pari, rregulla 2 e Rregullores e përkufizon fletarrestimin si një urdhër të lëshuar nga Dhomat e Specializuara kundër një të dyshuari ose të akuzuari në pajtim me nenin 41(6) ose nenin 42(8) të Ligjit. Përmendja në përgjithësi e "Dhomave të Specializuara" nuk mund të interpretohet se përjashton gjykatësit e vetëm, ose se i referohet ekskluzivisht gjykatësve të procedurës paraprake. I njëjti arsyetim vlen për nenin 41(6) të Ligjit, sipas të cilit vetëm Dhomat e Specializuara ose Prokurori i Specializuar urdhërojnë arrestimin dhe paraburgimin e një personi. Nëse Ligji do të synonte që kompetencën për lëshimin e fletarrestimit ta kufizonte ekskluzivisht vetëm tek Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në të do të ishte thënë shprehimisht kështu.

32. Rregulla 48(2) e Rregullores thekson në pjesën përkatëse se një "Panel" mund të lëshojë fletarrestime sikurse e lypin nevojat e hetimit. Rregulla 2 e Rregullores e përkufizon Panelin si një panel/trup gjykues ose si gjykatës individual. Rregulla 53 e Rregullores parasheh që paneli mund të lëshojë fletarrestim nëse është i bindur se përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit.

33. Përveç dispozitave që i referohen "Dhomave të Specializuara" ose "Panelit" dhe jo ekskluzivisht Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ka dispozita të tjera që parashohin mundësinë që fletarrestimi të lëshohet përpara konfirmimit të aktakuzës. Për shembull, rregulla 57(1) e Rregullores i referohet paraburgimit të një të dyshuari para caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe parasheh që paraburgimi i të dyshuarit rishikohet nga Gjykatësi i Vetëm i caktuar në pajtim me nenin 33(2) të Ligjit.

⁵² Aktvendim i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, datë 26 maj 2020, para. 16. Shih gjithashtu KSC-CC-PR-2017-01, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Aktvendim, 26 prill 2017, para. 14 ("Aktvendim i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese i 26 prillit 2017").

34. Rregulla 71(1) e Rregullores, e cila parasheh masa të përkohshme për ruajtjen e pasurisë dhe i referohet masave që mund të merren "pas lëshimit të një urdhri për arrestim apo fletarrestimi, ose pas konfirmimit të një aktakuze [...]", demonstroi më tej se është i mundur lëshimi i një fletarrestimi nga një gjykatës pavarësisht nëse aktakuza është dorëzuar ose jo. Paneli i Gjykatës së Apelit kujton në lidhje me këtë se fletarrestimi lëshohet nga gjykatësi, ndërsa urdhri i arrestimit lëshohet nga ZPS-ja.⁵³ Prandaj, masat e përkohshme për ruajtjen e pasurisë mund të urdhërohen kur fletarrestimi lëshohet nga gjykatësi, pavarësisht nëse është ngritur apo jo një aktakuzë.

35. Në kuadrin e sa më sipër, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se interpretimi i paraqitur nga z. Gucati, i cili sugjeron se ekziston një zbrazëti në dispozitat e Dhomave të Specializuara, nuk mund të pranohet. Përkundrazi, Paneli i Gjykatës së Apelit është bindur se një interpretim harmonik i dispozitave të Dhomave të Specializuara konfirmon që një Gjykatës i Vetëm, i caktuar në pajtim me nenin 33(2) të Ligjit, ka kompetencën të lëshojë fletarrestim para ngritjes së një aktakuze.⁵⁴

36. Paneli i Gjykatës së Apelit do të trajtojë tani pretendimin që duket se ngre z. Gucati për paragjykim si rezultat i mbrojtjeve shtesë që ai pretendon se do të kishte gëzuar në rast se do të ishte arrestuar nga ZPS-ja.⁵⁵ Në mënyrë specifike, z. Gucati pretendon se në rast se arrestimi i tij do të ishte urdhëruar nga ZPS-ja, vendimi për mbajtjen e tij në paraburgim do të ishte marrë brenda 48 orësh nga arrestimi, siç kërkohet nga neni 41(3) i Ligjit. Në vend të kësaj, vendimi për mbajtjen e tij në paraburgim u mor nga Gjykatësi i Vetëm vetëm më 27 tetor 2020. Më tej, z. Gucati parashtroi se, në përputhje me rregullën 57(1) të Rregullores, çdo kërkesë për zgjatjen e mbajtjes së tij në paraburgim duhet të ishte justifikuar justifikua me nevojën për të

⁵³ Rregulla 2 e Rregullores.

⁵⁴ Shih gjithashtu *Vendimin për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm*, para. 13-14.

⁵⁵ Kundërpërgjigja, para. 35-38.

kryer hetime të mëtejshme, kërkesë të cilën që ZPS-ja nuk e ka bërë që prej seancës së datës 1 tetor 2020.⁵⁶

37. Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se argumenti i z. Gucati është i pabazuar. Ndryshe nga sa pretendon z. Gucati, vendimi për paraburgimin e tij nuk u mor më 27 tetor 2020, datë kur Gjykatësi i Vetëm lëshoi Vendimin mbi kundërshtimet e Mbrojtjes ose Vendimin mbi Kërkesën për Dorëzani. Përkundrazi, ky vendim u mor më 25 shtator 2020 me lëshimin e Vendimit për fletarrestimet dhe lëshimin e fletarrestimit.⁵⁷ Këto dokumente i kanë ofruar z. Gucati një përshkrim të përmbledhur të fakteve në të cilat mbështetet arrestimi i tij, konstatimin ligjor për përmbushjen e kritereve të përmendura në nenin 41(6) të Ligjit, si dhe të drejtat e tij pas arrestimit.⁵⁸

38. Paneli i Gjykatës së Apelit më tej konstaton se rregulla 57(1) e Rregullores nuk i referohet detyrës së Gjykatësit të Vetëm për të vendosur mbi mbajtjen në paraburgim, por përkundrazi kompetencës së tij për të rivlerësuar rivlerësuar nëse vazhdojnë të përmbushen kushtet fillestare të mbajtjes në paraburgim. Në rastin në fjalë, seanca që u zhvillua më 1 tetor 2020 ishte seancë për paraqitjen e parë sipas parashikimeve të nenit 41 të Ligjit dhe rregullës 55(6) të Rregullores⁵⁹. Qëllimi i kësaj seance nuk ishte të rivlerësonte mbajtjen e z. Gucati në paraburgim sipas Rregullës 57(1) të Rregullores.⁶⁰

39. Për pasojë, lëshimi i fletarrestimit nga një gjykatës, në rastin konkret nga Gjykatësi i Vetëm, i ka ofruar z. Gucati më shumë mbrojtje, jo më pak mbrojtje siç pretendohet prej tij. Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se përmes kërimit të

⁵⁶ Kundërpërgjigja para. 35-38.

⁵⁷ Shih shënimin 6 më lart.

⁵⁸ Fletarrestimi, para. 1-10; *Vendim për Fletarrestimet*, para. 18-36.

⁵⁹ Transkript, datë 20 tetor 2020, f. 8. Shih gjithashtu transkriptin e datës 20 tetor 2020, f. 26.

⁶⁰ Duke qenë se për këtë çështje është caktuar një Gjykatës i Procedurës Paraprake, zbatohet rregulla 57(2) e Rregullores, e cila kërkon rishikimin e mbajtjes së z. Gucati në paraburgim brenda dy muajve nga vendimi i fundit për mbajtjen e tij në paraburgim. Shih F00061, *Vendim për Kaktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020. – Paneli vëren kalimthi se data e vendimit të fundit për mbajtjen në paraburgim është data 27 tetor 2020. Shih Vendimin mbi kundërshtimet e Mbrojtjes, Vendimin mbi Kërkesën për Dorëzani.

rishikimit dhe mbikëqyrjes së aktit të mohimit të lirisë nga një organ i pavarur gjyqësor, ZPS-ja ka bërë më shumë se sa i kërkohet me Ligj dhe ka vepruar në përputhje me vetë qëllimin e nenit 5 të GJEDNJ-së, përkatësisht mbrojtja e individit nga arbitrariteti.⁶¹

40. Për arsyet e përmendura më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se z. Gucati nuk demonstroi se Gjykatësi i Vetëm ka kryer gabim ligjor. Për pasojë, Paneli e rrëzon pikën e parë të apelit të z. Gucati.

C. PIKA E DYTË E APELIT TË Z. GUCATI: PRETENDIMI PËR GABIM LIDHUR ME REFUZIMIN E GJYKATËSIT TË VETËM PËR TË MIRATUAR DORËZANINË

1. Vëzhgim paraprak: koncepti i diskrecionit

41. Koncepti i diskrecionit, i përdorur nga jurisprudenca e cituar gjatë vendimit dhe i diskutuar nga ZPS-ja dhe nga z. Gucati,⁶² ka shkaktuar për një kohë të gjatë mjaft polemikë në ligjërimin juridik-filozofik dhe është larg të qenit i qartë.⁶³ Ndonëse përgjithësisht pranohet se diskrecioni nënkupton zgjedhje, ka pak konsensus lidhur me elementët e mëtejshëm përcaktues,⁶⁴ veçanërisht sepse diskrecioni mund të trajtohet nga këndvështrimet⁶⁵ ligjore, empirike, sociologjike, juridike, psikologjike

⁶¹ Shih, për shembull, ECtHR, *Witold Litwa v. Poland*, no. 26629/95, Judgement, 4 April 2020, para. 78; ECtHR, *S. V. and A. v. Denmark*, no. 35553/12, 36678/12 dhe 36711/12, Judgement, 22 October 2018 (“*S. V. dhe A. v. Denmark Case*”), para. 74; ECtHR, *Ruslan Yakovenko v. Ukraine*, no. 5425/11, Judgement, 4 September 2015, para. 45; ECtHR, *El-Masri v. The Former Yugoslav Republic of Macedonia*, no. 39630/09, Judgement, 13 December 2012, para. 230, 231. Shih gjithashtu F00120, *Kërkesë Urgjente për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to*, dosja KSC-BC-2020-07/F0009, datë 22 September 2020, 1 October 2020, para. 32, ku tregohet qartë angazhimi i ZPS-së për të vepruar në përputhje me të drejtat themelore të z. Gucati.

⁶² Përgjigjja e ZPS-së, para. 28; Kundërpërgjigjja e z. Gucati, para. 9-14.

⁶³ Paneli mbështetet këtu në një artikull të ardhshëm të shkruar nga Aleksander Heinze dhe Shanon Fyfe, i cili do të botohet në Ambos, K., Duf, A., Roberts, J. dhe Weigend, T., *Core Concepts in Criminal Law and Criminal Justice*. Volume 2, Cambridge University Press 2021. Për një përmbledhje të mirë nga këndvështrimi krahasues dhe ndërkombëtar, shih gjithashtu Meyer, F., “Discretion”, në Dubber dhe Hörnle (eds), *Oxford Handbook of Criminal Law*, Oxford University Press 2014 (“*Meyer, Discretion*”), f. 913.

⁶⁴ G.C. Christie, “An Essay on Discretion” (1986) 5 *Duke Law Journal* (“*Christie, Discretion*”), f. 747.

⁶⁵ Meyer, *Discretion*, f. 922. Shih gjithashtu Fletcher, G.P., “Some Unwise Reflections About Discretion” (1984) 47 *Law and Contemporary Problems*, f. 269 ff.

dhe funksionale. Fjalori juridik *Black's Law Dictionary* e përkufizon diskrecionin si: "liri në ushtrimin e gjykimit; kompetencë për vendimmarrje të lirë".⁶⁶ Fjalori juridik *Jowitt's Dictionary of Law* e përkufizon diskrecionin si: "gjykimin vetjak të një individi lidhur me atë që është më e mira në një rast të caktuar, në krahasim me një rregull që zbatohet për të gjitha çështjet e një lloji të caktuar"⁶⁷. Fjalori *The Compact Oxford English Dictionary*, duke u mbështetur në punën e hershme⁶⁸ të Isaacs, i referohet "veprimit të dallimit ose gjykimit", "aftësisë dalluese"⁶⁹. Mejer (Meyer), mbi bazën e një shqyrtimi të hollësishëm, jep një përkufizim të gjerë të termit, i cili i referohet "kompetencave ligjore që i jepen një gjykatësi për të zgjedhur midis disa mundësive, çdonjëra prej të cilave është e ligjshme në kontekstin e sistemit"⁷⁰.

42. Këto lloje përkufizimesh përmbledhëse përdorin kryesisht si bazë debatin modern filozofik ligjor, i cili ndoshta ka filluar me punën nismëtare dhe me shumë ndikim të Davis që nga viti 1969, i cili, përveç theksimit të lirisë së zgjedhjes⁷¹, përqendrohet te faktet: "Ushtrimi i diskrecionit mund të jetë një pjesë e konstatimit të fakteve dhe zbatimit të ligjit dhe konstatimi i fakteve mund të jetë një pjesë e ushtrimit të diskrecionit".⁷² Faktet më pas plotësohen me "vlera dhe ndikime",⁷³ ato të cilat Paneli i Gjykatës së Apelit mund t'i quajë si aspekti normativ (i bazuar në vlera) i diskrecionit. Për kontekstin gjyqësor është shumë i rëndësishëm dallimi midis

⁶⁶ Garner, B.A. (ed.), *Black's Law Dictionary* (11th Edition), Thomson West 2019, f. 585.

⁶⁷ Jowitt, W. et al., *Jowitt's Dictionary of English Law*, Thomson 1977, f. 624. Shih gjithashtu Gill, N. et al, "The Limits of Procedural Discretion: Unequal Treatment and Vulnerability in Britain's Asylum Appeals" (2018) 27(1) *Social and Legal Studies*, f. 49, 51.

⁶⁸ Isaacs, N., "The Limits of Judicial Discretion" (1923) 32 *Yale Law Journal*, f. 339-343.

⁶⁹ Wiener, E.S.C. dhe Simpson, J.A. (eds), *The Compact Oxford English Dictionary*, Oxford University Press 1987, f. 444 [756]: "veprimi i dallimit ose gjykimit", "aftësia dalluese".

⁷⁰ Meyer, *Discretion*, f. 924 (i cili i referohet Barak, A., *Judicial Discretion*, Yale University Press 1989, f. 90).

⁷¹ Davis, K.C., *Discretionary Justice*, Louisiana State University Press 1969, f. 15 ("një zyrtar publik ka diskrecion sa herë që kufijtë faktikë të kompetencave të tij e lënë të lirë të bëjë një zgjedhje midis veprimit ose mosveprimit të mundshëm").

⁷² *Po aty*, f. 16.

⁷³ *Po aty*.

diskrecionit parësor dhe dytësor,⁷⁴ i bërë nga Rozenberg. Ndërsa i pari i referohet "gamës së gjerë të zgjedhjeve" të vendimmarrësit, tashmë e përmendur më lart, diskrecioni dytësor "ka të bëjë me marrëdhëniet hierarkike midis gjykatësve", veçanërisht në kontekstin e rishikimit në apel, si një "koncept kufizues mbi rishikimin", ku "rregullat e rishikimit i akordojnë vendimit të gjykatës më të ulët një shkallë të pazakontë mbrojtjeje nga shqyrtimi i apelit".⁷⁵ Ndonëse edhe Duorkin (Dworkin)i referohet rëndësisë së zgjedhjes,⁷⁶ sipas tij standardet që drejtojnë ushtrimin e diskrecionit janë më të rëndësishme se vetë koncepti i diskrecionit.⁷⁷ Ai bën krahasimin e famshëm: "Diskrecioni, ashtu si vrima në mes të gjevrekut, nuk ekziston përveçse si një hapësirë e krijuar nga një brez rrethues kufizimi. Prandaj, ai është një koncept relativ".⁷⁸ Duorkin më tej bën dallimin midis kuptimit "të fortë" dhe dy kuptimeve "të dobëta" të diskrecionit, ku kuptimi i dytë "i dobët" i ngjan diskrecionit dytësor të Rozenbergut, i cili lidhet veçanërisht me kontekstin tonë, që shpjegon fushëveprimin e kufizuar të rishikimit (në nivel apeli).⁷⁹

43. Në këtë kontekst nuk është për t'u habitur që në juridiksionet shtetërore standardi i rishikimit gjyqësor është i kufizuar. Kështu, në Angli dhe Uells kriteri është ai i "paarsyeshmërisë", çka do të thotë se gjykatësit ndërhyjnë vetëm atëherë "kur një organ administrativ ka vepruar në mënyrë kaq të paarsyeshme saqë asnjë organ tjetër

⁷⁴ Rosenberg, M., "Judicial Discretion of the Trial Court, viewed from above" (1971) 22 *Syracuse Law Review* ("Rosenberg, *Discretion*"), f. 635-637.

⁷⁵ *Po aty*, f. 637, 638, 643 (në f. 648 gjithashtu i referohet 'respektimit të instancës së apelit'). Shih gjithashtu Christie, *Discretion*, f. 747, 748.

⁷⁶ Dworkin, R., "Judicial Discretion" (1963) 60(21) *The Journal of Philosophy*, f. 624 ("[...] e detyron gjykatësin të bëjë një zgjedhje [...] ushtrimi i zgjedhjes ose diskrecionit gjyqësor [...]") (theksimi në origjinal)).

⁷⁷ Dworkin, R., *Taking Rights Seriously*, Harvard University Press 1977, f. 31 ("Koncepti i diskrecionit i përshtatet vetëm një lloj konteksti; kur dikush është në përgjithësi i ngarkuar me marrjen e vendimeve në varësi të standardeve të vendosura nga një autoritet i veçantë").

⁷⁸ *Po aty*.

⁷⁹ *Po aty*, f. 32-33 ("Ndonjëherë ne e përdorim termin në një kuptim tjetër të dobët, për të thënë vetëm se një zyrtar i caktuar ka kompetencën përfundimtar për të marrë një vendim dhe vendimi nuk mund të rishikohet dhe të prapësohet nga një zyrtar tjetër [...]"). Shih gjithashtu Christie, *Discretion*, f. 750.

i arsyeshëm nuk mund të vepronte ashtu”.⁸⁰ Në përgjithësi, gjykatat ndërhyjnë në vendimet diskrecionale vetëm në rrethana të kufizuara dhe të jashtëzakonshme.⁸¹ Kështu, në Gjermani dhe në Angli/Uells, marrë së bashku, këto kushte janë: së pari, kur ushtrimi i diskrecionit bazohet në një interpretim të gabuar të ligjit; së dyti, kur ai ushtrohet mbi një përfundim qartazi të gabuar faktik; ose, së treti, kur vendimi është aq i padrejtë dhe i paarsyeshëm sa që përbën keqpërdorim të diskrecionit.⁸²

44. Pra, ndonëse është e qartë se diskrecioni ka të bëjë me natyrën përfundimtare të vendimit të gjykuesit të faktit, në kuptimin e autoritetit ose kompetencës së kufizuar të një instance më të lartë (në aspektin hierarkik) për ta rrëzuar vendimin, kjo nuk i përgjigjet pyetjes se cilat vendime mund të konsiderohen diskrecionale dhe se si mund të dallohen ato nga vendimet jodiskrecionale. Në të vërtetë, kësaj çështjeje i kushtohet vëmendje e vogël jo vetëm nga juridiksionet kombëtare,⁸³ por edhe nga gjykatat penale ndërkombëtare. Një arsye e rëndësishme për këtë zbrazëti ligjore është vështirësia për të bërë dallimin midis vendimeve jodiskrecionale dhe diskrecionale.⁸⁴ Në fakt, meqenëse termat dhe dispozitat ligjore janë për nga vetë natyra e tyre normative dhe, si të tilla, lënë vend për më shumë se një interpretim, mund të argumentohet se të gjitha vendimet janë diskrecionale. Megjithatë, çka është e sigurt

⁸⁰ Künnecke, M., *Tradition and Change in Administrative Law – An Anglo-German Comparison*, Springer 2007, f. 15; Kischel, U., *Comparative Law*, Oxford University Press 2019, nm. 289.

⁸¹ Për Anglinë dhe Uellsin, shih, për shembull, *English Court of Appeals, R v West Sussex Quarter Sessions*, 1973; *English Court of Appeals, Charles Osenton v. Johnston*, 1942; *English Court of Appeals, Holland v. Holland*; për Gjermaninë, shih, për shembull, *Bundesgerichtshof (Gjykata Federale e Drejtësisë e Gjermanisë)*, BGHSt. 6, 298-300; BGHSt. 10, 327-329; BGHSt. 18, 238.

⁸² Shih për Gjermaninë BGHSt 4, 255; BGHSt 5, 283; BGHSt 6, 199, 200; BGHSt 9, 71, 72; BGHSt 22, 267; 39, 200. Shih gjithashtu BGH JR 1955, 190; JR 1956, 426; BVerfGE 9, 223; BVerfGE 12, 333. Megjithatë, Paneli vëren kalimthi se në Gjermani rishikimi gjyqësor i koncepteve ligjore të papërkufizuara - ku autoriteti zyrtar nuk gëzon diskrecion, por *Beurteilungsspielraum* (vend për vlerësim ose hapësirë për gjykim, të barasvlershme me konceptin e “gjykimit interpretues” në traditën e së drejtës zakonore) - është i pakufizuar. Madje gjykatësit kanë edhe të drejtën të kryejnë shqyrtim *de novo*, domethënë t'i përkufizojnë vetë konceptet e papërcaktuara/të paqarta dhe të mos pyesin nëse zbatimi nga ana e subjektit ka qenë i drejtë (shih Kischel, U., *Comparative Law*, Universiteti i Oksfordit Press 2019, nm. 290).

⁸³ Shih studimin kritik Rosenberg, *Discretion*, f. 535, 653 (“vëmendje e pakët [...] ku duhet të jepet dhe si duhet të jepet” (theksimi në origjinal)).

⁸⁴ Shih gjithashtu Meyer, *Discretion*, f. 913, 923 (“Të gjitha çështjet e interpretimit ligjor (ose të gjykimit) janë, deri në një farë mase të pashmangshme, diskrecionale për nga natyra”), gjithashtu f. 928.

– edhe nga pikëpamja semantike – është se edhe diskrecioni përfshin një lloj kufizimi.⁸⁵ Ky vendim nuk është vendi për t'u thelluar më tej në këtë çështje, por mjafton të pohojmë se vendimet mbi mbajtjen në paraburgim para fillimit të gjykimit dhe mbi lirim të përkohshëm tradicionalisht karakterizohen si vendime diskrecionale.⁸⁶ Jurisprudenca përkatëse ndërkombëtare ka përqafuar të njëjtin qëndrim.⁸⁷ Paneli i Gjykatës së Apelit do t'u kthehet dispozitave përkatëse, veçanërisht atyre të Dhomave të Specializuara, më poshtë.

2. Vlerësimi i pikës së dytë të apelit të z. Gucati

45. Në pikën e dytë të apelit, z. Gucati kundërshton Vendimin mbi Kërkesën për Dorëzani. Z. Gucati e pranon konstatimin e Gjykatës të Vetëm se kushtet e propozuara në kërkesën e tij për dorëzani (“kushtet e propozuara”) trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme rrezikun e arratisjes.⁸⁸ Megjithatë, z. Gucati parashtron se Gjykatësi i Vetëm ka gabuar kur ka vendosur se kushtet e propozuara nuk trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme rrezikun e pengimit të zhvillimit të procedimit apo të kryerjes së veprave të tjera penale prej tij.⁸⁹ Z. Gucati pretendon më tej se Gjykatësi i

⁸⁵ Për ilustrim, shih Greenawalt, K., “Discretion and Judicial Decision: The Elusive Quest for the Fetters That Bind Judges”, (1975) 75 (2) *Columbia Law Review*, f. 365: “Kur një person nuk ka asnjë kufizim në zgjedhje, zakonisht nuk përdorim termin “diskrecion”. Ne themi që një zyrtar ka “diskrecion” për të përzgjedhur punonjësit e një kompanie, por nuk themi që një fëmijë ka “diskrecion” për të zgjedhur shijen e akullores që i pëlqen”.

⁸⁶ Shih, p.sh. Gottfredson, M.R. dhe Gottfredson, D.M., *Decision Making in the Criminal Justice System. Toward the Rational Exercise of Discretion* (Second Edition), Springer 1988, f. 82-91 (ku i kushtohet një kapitull i tërë vendimeve për lirim para gjykimit). Shih gjithashtu Gatgens, E., *Ermessen und Willkür im Straf- und Strafverfahrensrecht*, Peter Lang 2007, f. 278 ff.

⁸⁷ Shih poshtëshënimin 20 më lart. Shih gjithashtu ECCC, *Prosecutor v. Chea and Samphan*, 002/19-09-2007-ECCC-TC/SC(04) Decision on Immediate Appeal by Khieu Samphan on Application for Release, 6 Qershor 2011, para. 19, 53; për DHJGJK-në dhe përgjithësisht shih Sarygin, S., “Judicial Discretion in ECCC Decisions on Pre-Trial Detention Against the Backdrop of the Case-law of the International Criminal Tribunals” (2011) 11 *International Criminal Law Review*, f. 315–358.

⁸⁸ Apeli, para. 37.

⁸⁹ Apeli, para. 32-38, 47-58. Shih gjithashtu, Kundërpërgjigjja, para. 19. Z. Gucati përgjithësisht argumenton se urdhrat e lëshuara nga Gjykatësi i Vetëm janë respektuar. Më tej Gucati paraqet interpretimin e tij të ngjarjeve të pretenduara në kërkesën e ZPS-së për fletarrestime. Shih, Kundërpërgjigjja, para. 40-46, 56. Nën nëntitullin “Rrethanat dhe historiku procedural”, ZPS-ja përgjigjet me interpretimin e vet të ngjarjeve të pretenduara në kërkesën e ZPS-së për fletarrestime. Shih Përgjigjen e ZPS-së, para. 3-13, 32. U kujtojmë palëve se do të kenë mundësi të trajtojnë thelbin e

Vetëm ka gabuar kur rrëzoi argumentet e tjera të parashtruara prej tij përveç kushteve të propozuara.⁹⁰

46. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Vetëm e ka ushtruar me korrektësi diskrecionin e tij dhe ka bërë konstatimin e duhur se mbajtja në paraburgim e z. Gucati është e domosdoshme.⁹¹ ZPS-ja pretendon se keqinterpretimi nga z. Gucati i fakteve mbi të cilat u bazua arrestimi i tij demonstroi më tej që lirimi i tij do të sillte rreziqe konkrete.⁹² Sipas pikëpamjes së ZPS-së, z. Gucati thjesht përsërit parashtrimet që ishin të pasuksesshme në gjykim⁹³ dhe pretendon se propozimi i z. Gucati për të forcuar kushtet e propozuara duhet të rrëzohet.⁹⁴

47. Z. Gucati përgjigjet se vendimi nëse janë përmbushur arsyet për mbajtjen e tij në paraburgim, të parashikuara në nenin 41(6) të Ligjit, është çështje gjykimi, dhe jo ushtrim diskrecioni.⁹⁵ Z. Gucati parashtron më tej se edhe kur përmbushen arsyet për mbajtje në paraburgim të parashikuara në bazë të nenit 41(6) të Ligjit, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që duhet të urdhërohet mbajtja në paraburgim.⁹⁶

48. Në fillim, Paneli i Gjykatës së Apelit do të trajtojë natyrën e vendimeve për lirim të përkohshëm. Paneli mendon se ka një farë baze parashtrimi i z. Gucati që, në qoftë se nuk përmbushen arsyet për paraburgim sipas nenit 41(6) të Ligjit, nuk ka diskrecion dhe nuk mund të urdhërohet paraburgimi.⁹⁷ Në fakt, ky interpretim pasqyron

kësaj çështjeje gjatë gjykimit, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos të konfirmojë aktakuzën e paraqitur nga ZPS-ja. Shih, për shembull, Përgjigjja, para. 19.

⁹⁰ Apeli, para. 58.

⁹¹ Përgjigjja, para. 27-30.

⁹² Përgjigjja, para. 2, 31-32.

⁹³ Përgjigjja, para. 30.

⁹⁴ Përgjigjja, para. 33.

⁹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 9, 10, 12-14, 19. Në argumentet e z. Gucati ka disa mospërputhje. Ai gjithashtu parashtron se, duke qenë se Gjykatësi i Vetëm ka diskrecion mbi çështjen, ai duhet të urdhërojë lirin e Gucatit nën dritën e argumenteve të paraqitura në Apel. Kundërpërgjigjja e Gucatit, para. 20.

⁹⁶ Kundërpërgjigjja, para. 16. Gucati rikujton se heqja e lirisë është përjashtimi, jo rregulli, dhe se e drejta për liri si edhe prezumimi i pafajësisë e bëjnë balancën të anojë fuqimisht në favor të individit. Shih Kundërpërgjigjja, para. 17.

⁹⁷ Kundërpërgjigjja, para. 9-10.

kuptimin e drejtpërdrejtë të nenit 41(6) të Ligjit, sipas të cilit Dhomat e Specializuara ose ZPS-ja " urdhërojnë" arrestimin dhe paraburgimin e një personi "vetëm" kur plotësohen kushtet e detajuara brenda të njëjtit nen.

49. Vetë fakti që ka diskrecion nuk do të thotë, siç u shpjegua më lart, që një gjykatës mund të anashkalojë kuptimin e drejtpërdrejtë të Ligjit. Diskrecioni është një koncept i bazuar në rregulla dhe nuk lejon vendime të paligjshme dhe arbitrare. Kështu, në çështjen në fjalë, gjykatësi ka diskrecionin për të vlerësuar rrethanat e një personi të ndaluar që bën kërkesë për lirim të përkohshëm. Pesha që do t'u atribuohet garancive të tilla si kushtet e propozuara, mund të varet nga faktorë të shumtë. Për shkak se vendimet mbi lirimin e përkohshëm për nga vetë natyra e tyre lidhen me fakte konkrete ⁹⁸ Gjykatësi i Vetëm është autoriteti më i përshtatshëm për t'i vlerësuar këta faktorë. Prandaj, Paneli i Gjykatës së Apelit nuk do të ndërhyjë, përveç nëse apeluasi demonstroi ekzistencën e një gabimi qartësisht të dukshëm.

50. Ky koncept i diskrecionit dhe mënyra se si zbatohet ai, pasqyrohet mirë, për shembull, në rregulloret e TPNJ-së, TPNR-së dhe MPNTP-së lidhur me procedurat për kërkesat për lirim të përkohshëm, sipas të cilave dhomat gjyqësore duhet "të binden" që, nëse lirohet, i akuzuari do të paraqitet për gjykim dhe nuk do të paraqesë rrezik për asnjë viktimë, dëshmitar, ose person tjetër.⁹⁹ Për GJPN-në, neni 60(2) i Statutit të Romës përcakton një kriter për marrjen e vendimeve mbi kërkesat për lirim para gjykimit: nëse dhoma e procedurës paraprake është "e bindur" se janë

⁹⁸ Dhoma e Apelit e TPNJ-së ka vërejtur se për shkak se vendimet për lirim të përkohshëm për nga vetë natyra e tyre lidhen me fakte konkrete, kriteret përkatëse vlerësohen më mirë nga Dhomat Gjyqësore dhe se Dhoma e Apelit nuk do ta ndryshojë një vendim të tillë nëse nuk vërtetohet se është bërë një gabim i dukshëm. Shih, për shembull, ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-AR65.3, Decision on Interlocutory Appeal of Trial Chamber's Decision Denying Ljubomir Borovčanin Provisional Release, 1 March 2007, para. 14, që citon ICTY, *Prosecutor v. Milutinović et al.*, IT-05-87-AR65.2, Decision on Interlocutory Appeal of Denial of Provisional Release During the Winter Recess, 14 December 2006, para. 15.

⁹⁹ Shih, ICTR, Rule 65(B) of Procedure and Evidence; IRMCT Rule 68(B) of Procedure and Evidence. Prania e arsyeve humanitare mjaftueshmërisht bindëse mund të merret parasysh gjatë miratimit të një lirimi të tillë.

përmbushur kushtet e përcaktuara në nenin 58(1) të Statutit të Romës për lëshimin e një fletarrestimi¹⁰⁰, personi do të vazhdojë të mbahet në paraburgim.¹⁰¹

51. Krahësuar me këtë, ndonëse Dhoma e Specializuar e parashikon lirim të përkohshëm¹⁰², nuk ka dispozita specifike lidhur me standardin që duhet të zbatohet nga gjykatësi kur shqyrton një kërkesë për lirim të përkohshëm¹⁰³. Megjithatë, Ligji në mënyrë të nënkuptuar e autorizon gjykatësin të vlerësojë nëse kushtet e propozuara "eliminohen të gjitha rreziqet e nenit 41(6)(b)" siç përcaktohet me saktësi nga Gjykatësi i Vetëm.¹⁰⁴ Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit mendon se, në mënyrë të ngjashme me procedurën e zbatuar nga GJPN-ja, nëse një gjykatës i Dhomave të Specializuara që trajton një kërkesë për lirim të përkohshëm "bindet" se përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, personi do të vazhdojë të mbahet në paraburgim. Në këtë kuptim, vendimet për lirim të përkohshëm janë diskrecionale.

52. Paneli do të trajtojë tani kundërshtimet konkrete të z. Gucati.

3. Rreziku që z. Gucati mund të pengojë procedimin ose të kryejë krime të tjera

¹⁰⁰ Neni 58 i Statutit të Romës (Lëshimi i fletarrestimit ose fletëthirrjes nga Dhoma e Procedurës Paraprake), para. 1: "[a] në çdo kohë pas fillimit të hetimit, Dhoma e Procedurës Paraprake, me kërkesë të Prokurorit, lëshon fletarrestim për një person nëse, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave ose informacioneve të tjera të parashtruara nga Prokurori, ajo bindet se: (a) ka arsye për të besuar se personi ka kryer një krim brenda juridiksionit të Gjykatës; dhe (b) arrestimi i personit duket i domosdoshëm: (i) për të siguruar paraqitjen e personit në gjyq; (ii) për të siguruar që personi të mos pengojë ose të rrezikojë hetimin ose procedurat gjyqësore; ose (iii) kur është e zbatueshme, për të parandaluar personin nga vazhdimi i kryerjes së këtij krimi ose së një krimi të lidhur me të që përfshihet brenda juridiksionit të Gjykatës dhe që buron nga të njëjtat rrethana".

¹⁰¹ ICC, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-1, Under Seal, Decision on the Prosecutor's Application for a Warrant of Arrest of Mbarushimana, 28 September 2010 ("*Mbarushimana* Decision"), para. 47-50.

¹⁰² Shih nenet 41(5), 41(12) të Ligjit; rregullën 56 të Rregullores.

¹⁰³ Lidhur me këtë çështje, Gucati gjithashtu parashtron se dispozitat për arrestim dhe mbajtje në paraburgim në GJPN dhe TPNJ janë të ndryshme nga dispozitat e Dhomave të Specializuara. Kundërpërgjigja, para. 8-9.

¹⁰⁴ *Vendimi mbi Kërkesën për Dorëzani*, para. 2.

53. Z. Gucati parashtroi se Gjykatësi i Vetëm ka gabuar kur ka vendosur se kushtet e propozuara ishin të pamjaftueshme për të trajtuar rrezikun e pengimit të zhvillimit të procedimit apo kryerjes së krimeve të tjera prej tij.¹⁰⁵

54. Z. Gucati pretendon më tej se Gjykatësi i Vetëm nuk e ka trajtuar siç duhet secilin prej kushteve të propozuara, të cilat ai i ka cilësuar gabimisht si “garanci personale”¹⁰⁶. Ai po ashtu ka gabuar në nxjerrjen e përfundimit se z. Gucati nuk i ka respektuar urdhrat e Gjykatësit të Vetëm.¹⁰⁷

55. Në mbështetje të pohimit të tij se janë përmbushur kushtet për dorëzani, z. Gucati përsërit disa prej argumenteve që i ka parashtruar Gjykatësit të Vetëm gjatë paraqitjes së tij të parë, ose në kërkesën e tij për dorëzani.¹⁰⁸ Ai sugjeron më tej se kushtet e propozuara mund të bëhen më të rrepta, me qëllim që Paneli i Gjykatës së Apelit të bindet për dhënien e dorëzansë.¹⁰⁹

56. Paneli i Gjykatës së Apelit kujton dispozitat përkatëse të nenit 41(1) dhe (6) të Ligjit:

1. Askush nuk privohet nga liria nga Dhomat e Specializuara ose Prokurori i Specializuar, apo në emër të tyre, përveç në rrethana dhe në pajtim me procedurat e përcaktuara nga ky ligj dhe mbrojtjet e garantuara në nenin 29 të Kushtetutës.

[...]

¹⁰⁵ Apeli, para. 32-38, 47-57. Shih gjithashtu, Kundërpërgjigjja, para. 19.

¹⁰⁶ Apeli, para. 55.

¹⁰⁷ Apeli, para. 56. Shih shënimin 89 më lart.

¹⁰⁸ Krahaso F00038, *Kërkesë për Dorëzani*, 30 shtator 2020, para. 6, me Apelin, para. 47-52. Gucati përsërit se nuk ka sugjerim të përdorimit të forcës ose kërcënimeve; nuk ka asnjë sugjerim për dëm aktual që i është shkaktuar ndonjë personi; se dënimi maksimal i paraburgimit për vepra penale të ngjashme është mjaft i ulët; se ai është individ me karakter të mirë dhe njeri familjar; dhe se ai ka bashkëpunuar me ZPS-në gjatë arrestimit. Shih gjithashtu transkriptin e datës 1 October 2020, f. 18, rreshti 5, deri në f. 21, rreshti 2.

¹⁰⁹ Apeli, para. 54, 57. Gucati ofron, për shembull, përfshirjen e një kushti që ai të mos hyjë në Prishtinë, dhe/ose që atij t'i lejohet qasje vetëm në një aparat elektronik dhe vetëm për qëllime komunikimi, të dhënat e të cilit ai do t'ia japë ZPS-së.

6. Dhomat e Specializuara ose Prokurori i Specializuar urdhërojnë arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur:

a. ekziston dyshimi i bazuar se ai e ka kryer ndonjë vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe

b. ekzistojnë arsye të artikulueshme të besohet se:

- i. ekziston rreziku i arratisjes;
- ii. personi do të [...] pengojë kryerjen e procedimit penal duke ndikuar te dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; ose
- iii. [ekziston rreziku] se ai person do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një krim të tentuar ose do të kryejë një krim të cilin ka kërcënuar se do ta kryejë.

57. Paneli i Gjykatës së Apelit nuk gjen bazë në pretendimin e z. Gucati se Gjykatësi i Vetëm nuk i ka trajtuar siç duhet secilin prej kushteve të propozuara. Vendimi mbi Kërkesën për Dorëzani tregon se Gjykatësi i Vetëm i ka vlerësuar qartë kushtet e propozuara në pajtim me nenin 41(6)(b) të Ligjit.¹¹⁰

58. Në mënyrë specifike, Gjykatësi i Vetëm kujton se z. Gucati ka marrë pjesë në shpërndarjen e paautorizuar të informacionit konfidencial dhe jopublik dhe se shpërndarja ka vijuar edhe pasi z. Gucati ishte urdhëruar në dy raste që të mos i shpërndante ato.¹¹¹

59. Gjykatësi i Vetëm konstaton se asnjë nga kushtet e propozuara nuk garanton në mënyrë të mjaftueshme se z. Gucati nuk do të pengojë ecurinë e procedimit, ose se nuk do të kryejë krime të tjera.¹¹² Gjykatësi i Vetëm konstaton më tej se “çfarëdo garancish personale për moskryerje të një sjellje e tillë nuk janë të besueshme duke pasur parasysh deklaratat publike [të z. Gucati] në të cilat ai premtonte se do të vazhdojë

¹¹⁰ Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani, para. 6, 17-20.

¹¹¹ Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani, para. 16-18.

¹¹² Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani, para. 18, 20.

të nxjerrë informacion konfidencial dhe mosrespektimin prej tij të urdhrave të Gjykatësit të Vetëm”.¹¹³

60. Paneli i Gjykatës së Apelit mendon se mënyra në të cilën Gjykatësi i Vetëm i referohet sjelljes së z. Gucati duhet të kuptohet në kuadrin e analizës së tij dhe të konstatimit të bërë në pajtim me nenin 41(6) të Ligjit se provat vërtetojnë "dyshimin e bazuar" se z. Gucati "ka kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara".¹¹⁴ Paneli vëren se z. Gucati nuk e kundërshton konstatimin e Gjykatësit të Vetëm në këtë aspekt.¹¹⁵

61. Gjithsesi, Paneli i Gjykatës së Apelit kujton jurisprudencën përkatëse të GJPN-së, sipas së cilës "shkalla e arsyetimit do të varet nga rrethanat e çështjes", dhe detyrimi për të dhënë arsye "nuk kërkon domosdoshmërisht përmendjen individuale të të gjithë faktorëve që iu paraqitën për shqyrtim [dhomës përkatëse], por [kërkon që dhoma përkatëse] të identifikojë faktet që ajo i konstaton të rëndësishme për nxjerrjen e përfundimit të saj".¹¹⁶

62. Përveç pretendimeve të parashtruara nga ZPS-ja, rishikimi i Vendimit mbi Kërkesën për Dorëzani tregon më tej se Gjykatësi i Vetëm ka shqyrtuar gjithashtu në mënyrë të nënkuptuar edhe pozitën e z. Gucati si Kryetari i Shoqatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. Faktikisht, Gjykatësi i Vetëm vëren se nëse z. Gucati lirohet, ekziston rreziku që ai të vazhdojë të shpërndajë informacion konfidencial duke komunikuar lirisht me median ose me rrjetin e tij të veteranëve të UÇK-së, ose duke i botuar vetë materialet.¹¹⁷

¹¹³ *Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani*, para. 17, 19.

¹¹⁴ Shih nenin 41(6) të Ligjit.

¹¹⁵ Shih Apelin.

¹¹⁶ ICC, *Prosecutor v. Abd-Al-Rahman*, ICC-02/05-01/20-177, Judgment on the Appeal of Mr Ali Muhammad Ali Abd-Al-Rahman Against the Decision of Pre-Trial Chamber II, of 14 August 2020 entitled "Decision on the Defence Request for Interim Release", 8 October 2020, para. 42.

¹¹⁷ *Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani*, para. 16-18.

63. Paneli i Gjykatës së Apelit nuk sheh asnjë gabim sa i takon mbështetjes së Gjykatësit të Vetëm te pretendimet e parashtruara nga ZPS-ja dhe pozita e z. Gucati, që tregon për ekzistencën e kontakteve dhe të një rrjeti që mund të krijojë rrezikun që z. Gucati mund të pengojë procedurën apo mund të kryejë krime të tjera.¹¹⁸

64. Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se z. Gucati thjesht shpreh mospajtim me Gjykatësin e Vetëm¹¹⁹ dhe parashtron interpretimin e vet të ngjarjeve të ndodhura më 7, 16, 17 dhe 22 shtator 2020.¹²⁰ Thjesht mospajtimi i apeluesit me përfundimet e nxjerra nga paneli i shkallës së parë bazuar në faktet e disponueshme, ose me peshën që ai i ka dhënë faktorëve të veçantë, nuk mjafton për të përcaktuar një gabim të qartë.¹²¹

65. Në kuadrin e sa më lart dhe në përputhje me standardin e rishikimit të shpjeguar më sipër, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se z. Gucati nuk arrin të demonstrojë se konstatimet e Gjykatësit të Vetëm nuk janë të arsyeshme dhe se ai ka kryer një gabim të dukshëm në vlerësimin e domosdoshmërisë së mbajtjes në paraburgim të z. Gucati në pajtim me nenin 41(6) të Ligjit.

66. Në arritjen e këtij përfundimi Paneli i Gjykatës së Apelit mban parasysh kushtet shtesë të propozuara nga z. Gucati në kundërpërgjigjen e tij, të tilla si, për shembull, kushtin për të mos hyrë në Prishtinë, dhe/ose që atij t'i lejohet qasje vetëm në një aparat elektronik, të dhënat e të cilit ai do t'ia japë ZPS-së dhe të cilin do ta përdorë vetëm për qëllime komunikimi.¹²²

67. Paneli i Gjykatës së Apelit është i mendimit se kushtet shtesë të propozuara nga z. Gucati nuk do ta kishin ndryshuar vendimin e Gjykatësit të Vetëm. Në këtë aspekt,

¹¹⁸ Shih, për shembull, ICC, *Mbarushimana* Decision, para. 48-50; ICC, *Prosecutor v. Al-Bashir*, ICC-02/05-01/09-3, version i redaktuar publik, Decision on the Prosecution's Application for a Warrant of Arrest Against Omar Hassan Ahmad Al-Bashir, 4 March 2009, para. 233.

¹¹⁹ Apeli, para. 38.

¹²⁰ Apeli, para. 40-46. Shih gjithashtu më lart, poshtëshënimin 88.

¹²¹ ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/08-3249-Red, Public Redacted Version of Judgment on the Appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo Against the Decision of Trial Chamber III of 23 December 2014 entitled "Decision on 'Defence Urgent Motion for Provisional Release'", 20 May 2015, para. 18.

¹²² Apeli, para. 54.

Paneli kujton se për përcaktimin e domosdoshmërisë së mbajtjes në paraburgim “pyetja që ngrihet ka të bëjë me mundësinë, jo me pashmangshmërinë e një ngjarjeje në të ardhmen”.¹²³ Në kontekstin specifik të kësaj çështjeje, Paneli konstaton se z. Gucati nuk demonstroi se si kushtet shtesë të propozuara prej tij e zvogëlojnë rrezikun apo mundësinë që ai mund të pengojë procedimin ose të kryejë krime të tjera.

4. Argumente të tjera të paraqitura përveç kushteve të propozuara

68. Z. Gucati argumenton se Gjykatësi i Vetëm gaboi kur nuk mori parasysh bashkëpunimin e tij gjatë arrestimit, mungesën e aktakuzës, natyrën jo të dhunshme të veprave penale nën hetim, mungesën e kërcënimeve ose lëndimeve aktuale të pretenduara dhe dënimet e mundshme minimale që lidhen me veprat penale përkatëse (“argumentet shtesë”).¹²⁴

69. Në Vendimin mbi Kërkesën për Dorëzani, pas arritjes së përfundimit se mbajtja e z. Gucati në paraburgim ishte e domosdoshme, Gjykatësi i Vetëm iu referua argumenteve shtesë. Ai u kushtoi vëmendje këtyre faktorëve, por konstatoi se ato nuk cenojnë vlerësimin e rrezikut që z. Gucati mund të pengojë procedimet dhe të kryejë krime të tjera dhe as nuk e bëjnë vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të paarsyeshëm ose jo proporcional në rrethanat në fjalë.¹²⁵

70. Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se Gjykatësi i Vetëm nuk trajtoi me hollësi secilin nga parashtrimet e renditura më lart, por është i mendimit se ai nuk kishte detyrim ta bënte këtë.¹²⁶ Në të vërtetë, Paneli rikujton konstatimin e tij se z. Gucati nuk ka demonstruar se Gjykatësi i Vetëm bëri një gabim të dukshëm në vlerësimin e tij se mbajtja në paraburgim e z. Gucati është e domosdoshme sipas nenit 41(6) të Ligjit. Gjykatësi i Vetëm nuk kishte asnjë detyrim absolut që të merrte parasysh faktorë të

¹²³ ICC, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-283, Judgment on the Appeal of Mr Callixte Mbarushimana Against the Decision of Pre-Trial Chamber I of 19 May 2011 entitled “Decision on the ‘Defence Request for Interim Release’”, 14 korrik 2011, para. 60.

¹²⁴ Apeli, para. 58.

¹²⁵ *Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani*, para. 24.

¹²⁶ Shih para. 61 më lart.

tjerë përveç atyre të paraparë në nenin 41(6) të Ligjit para se të urdhëronte vazhdimin e mbajtjes në paraburgim.

71. Në lidhje me dënimet e mundshme minimale që lidhen me veprat penale përkatëse, Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se interesi publik për të mbrojtur integritetin e procedurave përmes ndjekjes efektive të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë nuk mund të nënvlerësohet. Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë, megjithëse nuk janë aq të rënda sa krimet thelbësore të parapara sipas neneve 13 dhe 14 të Ligjit, janë gjithsesi vepra penale të rënda.

72. Paneli i Gjykatës së Apelit përfiton nga ky rast për të theksuar se natyra e veprës penale si dhe ashpërsia e dënimit janë faktorë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh kur vendoset nëse paraburgimi është i nevojshëm në rrethanat e një çështjeje specifike. Në lidhje me këtë, GJEDNJ-ja ka konfirmuar se mbajtja në paraburgim në pajtim me nenin 5(1)(c) të KEDNJ-së përfshin kushtin e proporcionalitetit. Si pasojë, GJEDNJ-ja zbaton kriterin e proporcionalitetit kur shqyrton nëse mbajtja në paraburgim e parashtruesit të kërkesës është rreptësisht domosdoshme për të siguruar praninë e tij në gjykim apo nëse për këtë qëllim mund të jenë të mjaftueshme masa të tjera më pak të rrepta.¹²⁷ Kjo është në përputhje me praktikën e institucioneve të tjera të të drejtave

¹²⁷ ECtHR, *S. V. and A. v. Denmark*, para. 161; ECtHR, *Ladent v. Poland*, no. 11036/03, Judgment, 18 March 2008, para. 55; ECtHR, *Ambruszkiewicz v. Poland*, no. 38797/03, Judgment, 4 May 2006, para. 29-32.

të njeriut¹²⁸ dhe gjykatave penale ndërkombëtare.¹²⁹ Më e rëndësishmja, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian për herë të parë sqaron qartë se: "çdo kufizim i ushtrimit të të drejtave dhe lirive" "kushtëzohet nga parimi i proporcionalitetit".¹³⁰

73. Paneli i Gjykatës së Apelit është plotësisht i vetëdijshëm për kufizimin e rëndë të të drejtave themelore që i shkakton individit heqja e lirisë. Ai është gjithashtu i vetëdijshëm për rëndësinë e kriterit të proporcionalitetit në këtë drejtim.¹³¹ Madje, ai

¹²⁸ Shih IACtHR, *Dorzema et al. v. Dominican Republic*, Judgment, 24 October 2012, para. 133; IACtHR, *Panday v. Suriname*, Judgment, 21 January 1994, para. 47. Në këto çështje, GJNADNJ-ja është shprehur se: "askush nuk mund t'i nënshtrohet paraburgimit ose burgimit për arsye dhe përmes mjeteve që, megjithëse klasifikohen si të ligjshme, mund të konsiderohen të papajtueshme me respektimin e të drejtave themelore të njeriut, sepse ato janë, ndër të tjera, të paarsyeshme, të paparashikueshme ose joproporcionale." (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu, IAComHR, Principles and Best Practices on the Protection of Persons Deprived of Liberty in the Americas, approved by the Commission during its 131st regular period of sessions, held from March 3-14, 2008, , Parimi III ("heqja e lirisë për qëllime parandaluese është një masë paraprake, jo ndëshkuese, e cila gjithashtu duhet të pajtohet me parimet e ligjshmërisë, prezumimin e pafajësisë, nevojën dhe proporcionalitetin, në masën që është rreptësisht e nevojshme në një shoqëri demokratike" (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu, në bazë të nenit 9 të ICCPR, HRCCom, *Mikhail Marinich v. Belarus*, Communication no. 1502/2006, Views, 19 August 2010, para. 10.4; HRCCom, *Kulov v. Kirghizistan*, Communication No. 1369/2005, Views, 19 August 2010, para. 8.3; HRCCom, *Fongum Gorji-Dinka v. Cameroon*, Communication no. 1134/2002, Views, 17 March 2005, para. 5.1; HRCCom, *Mukong v. Cameroon*, Communication no. 458/1991, Views, 10 August 1994, para. 9.8.

¹²⁹ Shih ICTY, *Prosecutor v. Blagojević et al.*, IT-02-53-PT, Decision on Request for Provisional Release of Accused Jokić, 28 March 2002, para. 18 ("Për më tepër, kur interpretohet rregulla 65, duhet të merret parasysh parimi i përgjithshëm i proporcionalitetit. Një masë e të drejtës ndërkombëtare publike është proporcionale vetëm kur (1) është e përshtatshme, (2) e nevojshme dhe kur (3) shkalla dhe fushëveprimi i saj qëndrojnë në një lidhje të arsyeshme me synimin e parashikuar. Masat procedurale nuk duhet të jenë kurrë kapriçioze ose të tepruara. Nëse mjafton të përdoret një masë më e butë, duhet të zbatohet ajo masë"). Shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-AR73.1, Decision on Prosecution's Urgent Interlocutory Appeal from Consolidated Decision on the Continuation of the Proceedings, 4 March 2016, para. 24-25; IRMCT, *Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-PT, Decision on Anselme Nzabonimpa's Second Motion for Provisional Release, 19 June 2019, para. 20. Kjo është gjithashtu në përputhje me juridiksionet shtetërore, shih, për shembull, në Gjermani, VGJK 19, 342, 347-48; VGJK 20, 45, 49.

¹³⁰ Neni 52 (1) i Kartës vijon të sqarojë se: "kufizime të tilla mund të bëhen vetëm nëse ato janë të domosdoshme dhe plotësojnë vërtet objektivat e interesit të përgjithshëm të njohur nga Bashkimi, ose nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve." Shih gjithashtu nenin 49(3) të Kartës, ku parimi përmendet për herë të parë në mënyrë të qartë në lidhje me dënimet; lidhur me këtë shih, Ambos, K. *European Criminal Law*, Cambridge University Press 2018 ("Ambos, *European Criminal Law*"), f. 145-146.

¹³¹ Shih Aktvendimin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese të 26 prillit 2017, para. 112-114. Shih në përgjithësi, Steiker, C.S., "Proportionality as a Limit on Preventive Justice", në Ashworth, A., Zedner, L. dhe Tomlin, P (eds), *Prevention and the Limits of Criminal Law*, Oxford University Press 2013, f. 194 rreshti (që i referohet shprehimisht paraburgimit para fillimit të gjykimit në f. 198); Billis, E.,

vëren se sa më gjatë të mbahet një individ në paraburgim para gjykimit, aq më shumë përgjegjësi kanë Dhomat e Specializuara për të arsyetuar vazhdimin e paraburgimit.¹³² Megjithatë, në çështjen në fjalë, duke vërejtur se z. Gucati mbahet në paraburgim që prej datës 25 shtator 2020 dhe se, më shumë se dy muaj pas arrestimit, akuza kundër tij edhe nuk është konfirmuar,¹³³ Paneli mendon se mbajtja e tij në paraburgim është ende proporcionale në këtë fazë të hershme të procedurës.

74. Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit hedh poshtë parashtrimin e z. Gucati se Gjykatësi i Vetëm gaboi kur nuk i mori parasysh argumentet shtesë. Pasi konstatoi se z. Gucati nuk ka demonstruar që Gjykatësi i Vetëm ka bërë një gabim të dukshëm, Paneli e hedh poshtë pikën e dytë të apelit të z. Gucati.

D. KËRKESA E Z. GUCATI PËR SEANCË DËGJIMORE

75. Në kundërpërgjigjen e tij, z. Gucati parashtron se duhet t'i miratohet mbajtja e një seance ("Kërkesë për Seancë") për shkak se: (i) apeli ka të bëjë me një ndër të drejtat themelore bazë, përkatësisht me të drejtën për liri; (ii) apeli ngre një argument të ri; dhe (iii) kërkesa për seancë në shkallën e parë u refuzua nga Gjykatësi i Vetëm.¹³⁴

76. Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton që rregulla 170(3) e Rregullores parashikon që: "përveç nëse paneli i Gjykatës së Apelit ka vendosur ndryshe, vendimet për apelet e ndërmjetme merren mbi bazën e parashtrimeve me shkrim". Paneli më tej vëren se kërkesa për seancë u paraqit nga z. Gucati në kundërpërgjigje dhe jo në apelin e tij,

Knust, N. dhe Rui, J.P. (eds), *Proportionality in Criminal Control and Criminal Justice*, Hart 2021 (që pritet të botohet).

¹³² Shih, për shembull, IRMCT, *Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-PT, Decision on Order to Show Cause, 1 October 2019, para. 11-13.

¹³³ Shih, për shembull, Përgjigjja, para. 19.

¹³⁴ Kundërpërgjigjja, para. 40.

duke i hequr kështu ZPS-së mundësinë të përgjigjej në lidhje me të. Sidoqoftë Paneli do të vendosë mbi këtë kërkesë, pasi vendimi i tij nuk e dëmton ZPS-në.

77. Vendimi për të lejuar mbajtjen e një seance është çështje diskrecioni.¹³⁵ Z. Gucati nuk argumenton dhe nuk përpiket të demonstrojë se Gjykatësi i Vetëm ka keqpërdorur diskrecionin e tij kur vendosi të mos mbahej seancë. Për më tepër, një kërkesë e tillë mund të konsiderohet e panevojshme kur, si në rastin aktual, informacioni para Panelit të Gjykatës së Apelit është i mjaftueshëm për të mundësuar dhënien e vendimit prej tij. Rrjedhimisht, kërkesa e z. Gucati në këtë aspekt hidhet poshtë.

IV. VENDIM

78. Për arsyet e përmendura më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit:

REFUZON kërkesën për mbajtjen e një seance; dhe

RRËZON apelin në tërësinë e tij.

/nënshkrim/

Gjykatëse Mishelë Pikar,

Kryegjykatëse

E mërkurë, 9 dhjetor 2020

¹³⁵ Shih, për shembull, ICTY/TPNJ, *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66-AR65, Vendim mbi Kërkesën e Fatmir Limajt për Lirim të Përkohshëm, 31 tetor 2003, para. 17. Shih gjithashtu ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-558, Judgment on the Appeal of Mr Aïme Kilolo Musamba Against the Decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision on the *Demande de mise en liberté provisoire de Maître Aïme Kilolo Musamba*", 11 korrik 2014, para. 47-48.

Në Hagë, Holandë.

V. SHTOJCË: PËRKUFIZIMI I TERMAVE DHE SHKURTIMEVE**Apeli**

KSC-BC-2020-07/IA001/F00001/A01, Njoftim për Apel të Ndërmjetëm në Emër të Hysni Gucatit (“apeluesi”), 3 nëntor 2020, dhe Njoftim për Apel të Ndërmjetëm në Emër të Hysni Gucatit (“apeluesi”), 3 nëntor 2020, Shtojca 1 (publike)

BGH

Bundesgerichtshof (Gjykata Federale e Drejtësisë [e Gjermanisë])

BGHSt

Bundesgerichtshof für Strafsachen (Panelet e së Drejtës Penale të GjFD-së)

BverfGE

Bundesverfassungsgericht Entscheidungen (Vendimet e Gjykatës Kushtetuese [të Gjermanisë])

Paneli i Gjykatës së Apelit, ose Paneli

Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit i Dhomave të Specializuara të Kosovës

ECCC

Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias

ECHR/KEDNJ

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 4 nëntor 1950

ECtHR/GJEDNJ

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

ff.

I referohet një faqeje ose një rreshti të përmendur dhe dy ose më shumë faqeve ose rreshtave pas tyre.

Poshtëshënim(e).

Shënim(e) në fund të faqes

Gucati

Z. Hysni Gucati

HRCCom/KDNJ

Komiteti për të Drejtat e Njeriut

IAComHR

Komiteti Ndëramerikan i të Drejtave të Njeriut

IACtHR

Gjykata Ndëramerikane e të Drejtave të Njeriut

ICC/GJPN

Gjykata Penale Ndërkombëtare

ICCPR/KNDCP

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2200 A (XXI), UN Doc. A/RES/21/2200, 16 dhjetor 1966, hyrë në fuqi më 23 mars 1976

ICTR/TPNR

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ndjekjen e personave përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të ligjit humanitar ndërkombëtar të kryera në territorin e Ruandës dhe të qytetarëve ruandezë përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera të tilla të kryera në territorin e shteteve fqinje, midis 1 janarit 1994 dhe 31 dhjetorit 1994

ICTY/TPNJ

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ndjekjen e personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991

IRMCT/MPNTP

Mekanizmi Përmbyllës Ndërkombëtar i Tribunalëve Penalë

JR

Juristische Rundschau (Shqyrtim ligjor)

UÇK

Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Ligji

Ligji nr. 05/L-053 “Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”

nm.

Numër marginal

f.

faqe (faqet)

para.

paragrafi (paragrafët)

Kundërpërgjigja

KSC-BC-2020-07/IA001/F00004, *Kundërpërgjigje e Apeluesit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë*, 19 nëntor 2020 (publike)

Përgjigja

KSC-BC-2020-07/IA001/F00003, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelimit prej Mbrojtjes të Vendimit për Refuzimin e Lirimit*, 13 nëntor 2020 (publik)

Statuti i Romës

Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, i hapur për nënshkrim më 17 korrik 1998, 2187 UNTS 3, hyrë në fuqi më 1 korrik 2002

Rregullorja

Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (versioni i përditësuar ka hyrë në fuqi më 2 qershor 2020)

SCSL

Gjykata Speciale për Sierra Leonen

Dhomat e Specializuara

Dhomat e Specializuara të Kosovës

ZPS

Zyra e Prokurorit të Specializuar

STL

Tribunali Special për Libanin

Të dyshuarit

Z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj

Transkript

Transkripte nga seancat për çështjen në fjalë, të gjitha referencat janë nga procesverbali zyrtar në gjuhën angleze, përveç nëse specifikohet ndryshe.